Modeli i rëndomtë i shtresuar sipas rajoneve dhe të gjitha grupeve të synuara kryesore.

Madhësia e modelit

200 intervista

Grupet e synuara

Popullata e synuar për këtë hulumtim është popullata e shfrytëzuesve apo klientëve potencial të legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë.

Grupet e synuara kryesore janë:

- Avokatët
- Gjyqtarët
- Praktikantë ligjor
- Zyrtarët publik dhe administrativ UNMIK&IPVQ
- OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare
- Fakulteti dhe studentët e drejtësisë
- Tregu potencial i komunitetit ligjor jashtë Kosovës

Përzgjedhja e respondentëve

Përzgjedhja e respondentëve për secilin grup ka qenë e rastit, nga lista e të gjithë anëtarëve të grupeve të synuara. Për shembull, nëse duam të kemi një model të rastit për gjyqtarët, atëherë duhet të kemi listën e të gjithë gjyqtarëve në Kosovë nga radhët e të cilëve do të bënim zgjedhjen e rastit të një numri të caktuar gjyqtarësh. Parimi i njëjtë zbatohet edhe për grupet tjera të synuara.

Organizimi i punës në terren

Numri i përgjithshëm i intervistuesve të angazhuar në këtë hulumtim ka qenë 10.
Numri i nevojshëm i koordinatorëve ka qenë i angazhuar në parimin një koordinator për jo më tepër se 5 intervistues. Së këndejmi, kanë qenë të angazhuar 2 koordinatorë. Menaxheri i terrenit për pjesën Shqipe të modelit ka qenë i vendosur në zyrën e Prism Research në Prishtinë.

Numri i kontrolluesve ka qenë i përcaktuar në të njëjtën mënyrë. Një kontrollues për jo më tepër se pesë intervistues – pra kanë qenë të angazhuar dy kontrollues.

Marrë parasysh që ky hulumtim është zhvilluar në tërë territorin e Kosovës, i është kushtuar vëmendje të siguruarit që struktura etnike e intervistuesve t'i përgjigjet strukturës etnike rajonale të modelit.

Trajnimi

Të gjithë koordinatorët rajonal dhe intervistuesit kanë marrë pjesë në trajnimin e plotë një ditor në Prishtinë.
Gjatë trajnimit të koordinatorëve dhe intervistuesve janë mbuluar fushat në vijim:

- Shpjegimi i qëllimit të projektit
- Shqyrtimi seksion për seksion i pyetësorit (analiza PpërP)
- Intervistat testuese me intervistuesit tjerë (lozja e roleve)
- Diskutimi gjithëpërfshirës i shqyrtimit udhëzues dhe jo-udhëzues

Pilot studimi

Para fillimit të punës kryesore në terren, secili intervistues është dashur të kompletojë të paktën një intervistë testuese para se të ishte i përshtatshëm për të marrë pjesë në punën në terren. Pas kompletimit të intervistave testuese, janë mbledhur të gjithë pyetësorët, dhe është mbajtur diskutimi lidhur me problemet që janë hasur, pyetjet që janë parashtruar etj. Intervistuesit kanë qenë të udhëzuar të mbajnë shënime për të gjitha komentet e bëra nga respondentët gjatë zhvillimit të intervistës. Në këtë mënyrë janë zhvilluar të paktën 50 intervista testuese si pjesë e pilot studimit.

Mbikëqyrja

Ashtu si është përmendur, secili intervistues është dashur të zhvillojë të paktën një intervistë me apo pa pjesëmarrjen e koordinatorit (varësisht nga niveli i gabimeve nga pilot studimi). Gjatë zhvillimit të punës në terren, koordinatorët kanë kontrolluar secilin pyetësor pas dorëzimit, për të pakësuar mundësinë e pyetësorëve të kompletuar gabimisht apo për të shmangur mundësinë që gabimet e intervistuesve të mbeten që pakontrolluara.

Kontrolli i cilësisë së intervistave

Puna e intervistuesve është kontrolluar në këto mënyra:

- shënimet për të gjitha kontaktet në terren dhe intervistat e kompletuara (100 %) për të kontrolluar nëse intervistuesi ka ndjekur rregullat e zgjedhjes së mostrave
- kontrolli logjik i pyetësorëve (100 %), që tregon nëse pyetësori është kompletuar në mënyrën e duhur dhe nëse të gjitha përgjigjet janë shenjuar si duhet
- kontrolli përmes telefonit (min 30%), për të shqyrtuar sjelljen e intervistuesit dhe administrimin e pyetësorit
- kontrolli në terren (min. 30 %) ku gjithashtu bëjmë kontrollimin e përzgjedhjes së duhur të respondentit në shtëpi, sjelljen e intervistuesit dhe administrimin e pyetësorit.

§ kontrolli kompjuterik i të dhënave të mbledhura (100%), ku bëjmë identifikimin e dallimeve që mund të shfaqen në mes të intervistuesve.

Futja e të dhënave dhe pastrimi

Përdorimi i programit për futjen e të dhënave ku formulari për futjen e të dhënave është krijuar në formë të pyetësorit. Çelësi i operatorëve të trajnuar në futjen e të dhënave. Të dhënat më pas pastrohen, domethënë gabimet që mund të jenë shfaqur gjatë futjes së të dhënave eliminohen duke përdorë programe specifike kompjuterike. Për kontrollimin dhe përgatitjen e të dhënave për përpunim të mëtejmë përdoret programi SPSS.

Organizimi

Është me rëndësi të theksohet që Prism Research ka rrjetin e tij të intervistuesve në pjesët me shumicë serbe/ enklavat në Kosovë, si dhe në zonat me shumicë shqiptare. Si trajnuesit serbë ashtu edhe ata shqiptarë janë trajnuar në të njëjtën mënyrë dhe kanë nivelin e ngjashëm (të konsiderueshëm) të përvojës. Të dy ekipet e intervistuesve janë përgatitur dhe trajnuar për këtë projekt në mënyrë të ngjashme. Rrjeti i intervistuesve dhe koordinatorëve të Prism Research Kosova funksionon si një ekip i vetëm, megjithatë për shkak të rrethanave ata janë ndarë në dy grupe, për shkaqe sigurie.

Pyetësori

Prism Research ka përpiluar pyetësorin në konsultim të ngushtë me NCSC. Prism Research ka kompletuar përkthimin dhe formën e pyetësorit. Pyetësori është përkthyer në gjuhën e vendit – në Shqip.

9.2. Hulumtimi kualitativ

Hyrje

Hulumtuesit social përgjithësisht pajtohen që dizajnet më efikase të hulumtimeve janë ato që shfrytëzojnë qasje të ndryshme metodologjike për të plotësuar njëra tjetrën – në rend të parë metodat kualitative e kuantitative. Në rastet kur problemi që shqyrtohet është relativisht i pa studiuar në dimensionet kulturore, sociologjike madje edhe psikologjike, më së miri është të ndërmerren hapat e parë hulumtues me përdorimin e qasjes kualitative – kryesisht përmes diskutimeve me grupet e fokusit dhe intervistat e hollësishme. Përmes këtyre grupeve dhe intervistave ne fitojmë njohuri më të thella në sfondin komplet të opinioneve dhe qëndrimeve, shkaqeve dhe motivacioneve të grupeve të synuara, për sa i përket çështjes që hulumtohet. Veç kësaj, diskutimet me grupet e fokusit dhe intervistat e hollësishme janë një mënyrë efikase për testimin e disa prej hipotezave tona fillestare dhe supozimeve. Është me rëndësi të përmendet që mënyra më e mirë për përgatitjen e pyetësorit për studimin kuantitativ është përmes testimit, studimit dhe definimit të pyetjeve të caktuara në hulumtimin kualitativ.

Metoda:

Intervistat e hollësishme.

Rekrutimi:

Prism Research ka një rrjet të gjerë që përbëhet nga intervistuesit, kontrolluesit, koordinatorët dhe mbikëqyrësit në të gjitha komunat e Kosovës – përfshirë këtu zonat me shumicë shqiptare dhe serbe si dhe të gjitha pakicat tjera etnike. Të gjithë intervistuesit kanë kompletuar një trajnim rigoroz mbi metodologjinë dhe pjesa më e madhe e tyre kanë marrë pjesë në të paktën 5 projekte hulumtuese në Kosovës gjatë 12 muajve të shkuar.

Intervistuesit/rekrutuesit kanë përdorur metodën Snowball (top bore) për përzgjedhjen e respondentëve potencial – informantët kyç nga grupet e ndryshme të synuara.

Në mënyrën e përshkruar më lartë, janë identifikuar të paktën 2 respondentë potencial për secilën nga intervistat e hollësishme.

Në bazë të kësaj përzgjedhjeje ne kemi identifikuar numrin optimal prej 20 respondentëve për të paktën 10 intervista të hollësishme të finalizuara.

Në përzgjedhjen finale të pjesëmarrësve që do të marrin pjesë në diskutimet e grupeve të fokusit dhe në intervistat e hollësishme, përveç kritereve themelore vëmendje e veçantë u është kushtuar elementeve në vijim:

4. që personat që janë në lidhje me intervistuesit dhe punëtorët e Prism Research të mos rekrutohen dhe që pjesëmarrësit të mos jenë në lidhje me njëri tjetrin;
5. që pjesëmarrësit të mos punësohen apo angazhohen në çfarëdo mënyre me mediat, organizatat e marketingut, agjencitë që merren me hulumtimin e tregut apo agjencitë që merren me sondazhet e opinionit publik;
6. që ata të mos kenë marrë pjesë në çfarëdo lloji të sondazheve të opinionit publik apo në diskutimet e grupeve të fokusit, në 12 muajt e fundit.

Grupet e synuara:

Grupet e synuara kryesore janë:

- Avokatët
- Gjyqtarët
- Praktikantët ligjor
- Zyrtarët publik dhe administrativ të UNMIK & IPVQ
- OJQ-të vendore e ndërkombëtare
- Fakulteti dhe studentët e Drejtësisë

Kemi zhvilluar 10 intervista të hollësishme me grupet e synuara kryesore.

Moderimi:

Intervistimi i respondentëve për IDI është bërë nga stafi ynë i jashtëm permanent në Kosovë (i angazhuar për projektin). Intervistuesit janë psikologë apo sociologë dhe kanë qenë të koordinuar dhe të mbikëqyrur nga Menaxheri i Projektit nga zyra qendrore e Prism Research, që drejton departamentin e hulumtimit kualitativ.

Transkriptet:

Diskutimet e IDI janë transkriptuar në tërësi në gjuhën e vendit dhe më pas janë përmbledhur në gjuhën angleze.

Lehtësirat:

Cilido vend i pajtuar me respondentët.

Udhëzuesit për diskutime:

Prism Research ka përpiluar Udhëzimet për diskutime, për intervistat e hollësishme, pas diskutimit dhe identifikimit të fushave, temave e çështjeve kyçe nga Klienti dhe Prism Research.

Organizimi:

Të gjitha diskutimet e grupeve të fokusit janë regjistruar në audio – në mënyrë jo të bezdisshme.

Pjesëmarrësit për IDI kanë marrë honorare simbolike për pjesëmarrje.

Janë servuar pije freskuese.

10. Përmbledhje e rezultateve

§ Më tepër se gjysma e respondentëve të survejuar mendojnë që informatat mbi ligjet e zbatuara në Kosovë janë në dispozicion. Madje 20.3% e anëtarëve të survejuar të popullatës së klientëve potencial të publikimeve të shtypura, mendojnë që informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë nganjëherë ka qenë vështirë të sigurohen, ndërsa 13.9% mendojnë që ato sigurohen me vështirësi.

§ Gati dy të tretat (64.4%) e të gjithë respondentëve të survejuar në shtrirjen e këtij hulumtimi kanë thënë që janë mjaft të kënaqur me disponueshmërinë e ligjeve dhe materialit tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë. Vetëm 9.9% e respondentëve kanë theksuar që janë plotësisht të kënaqur, ndërsa 9.4% e tyre thonë që janë plotësisht të pakënaqur me disponueshmërinë e ligjeve dhe materialit tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë.

§ Të pyetur rreth burimit primar të informacioneve lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, përgjigja më e shpeshtë ka qenë Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, që është përmendur si burimi kryesor i informacionit nga 45% të respondentëve. Pas kësaj vie materiali në CD Rom nga ABA/CEELI (17.3%), Publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës (14.9%), dhe ueb faqja e Kuvendit të Kosovës (12.4%). Përgjigjet tjera më të rralla janë treguar grafikisht.

§ Të pyetur nëse pranojnë rregullisht ndonjë lloj të publikimit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, saktësisht gjysma e respondentëve janë përgjigjur pozitivisht.

§ Pjesa më e madhe e respondentëve që pranojnë rregullisht ndonjë lloj të publikimit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër të zbatueshëm në Kosovë, kanë thënë që marrin Gazetën Zyrtare të UNMIK-ut (68.3%). Pas kësaj vie materiali në CD Rom nga ABA/CEELI CD (36.6%) dhe Publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës (31.7%).

§ Pjesa më e madhe e respondentëve që shfrytëzojnë Gazetën Zyrtare të UNMIK-ut, e marrin këtë publikim një herë në muaj (37.7%) ndërsa të tjerët për çdo tre muaj (30.4%). Për sa i përket publikimit në CD Rom të ABA/CEELI, një e treta e

respondentëve kanë thënë që këtë publikim e marrin një herë në vit (32.4%) ndërsa pjesa tjetër për çdo tre muaj (27%). Për sa i përket publikimit të Qendrës Juridike të Kosovës, distribuimi i rezultateve tregon që ky publikim nuk ka pasur ndonjë vazhdimësi të zakonshme të distribuimit tek klientët.

§ Pjesa më e madhe e publikimeve për shumicën e respondentëve është distribuuar pa pagesë dhe shuma maksimale të cilën klientët e këtyre publikimeve e kanë ndarë për këtë qëllim nuk ka kaluar 10 Euro.

§ Pjesa më e madhe e klientëve janë kryesisht të kënaqur me publikimet lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, marrë parasysh faktin që tre nga katër respondentët (77.2%) deklarojnë që janë mjaft të kënaqur me publikimet në dispozicion.

§ Respondentët që kanë marrë më parë disa nga publikimet ekzistuese, vlerësojnë që përmbajtja e publikimit është elementi më i rëndësishëm në zgjedhjen e publikimit të cilin do ta kishin porositur ose blerë për nevojat e tyre profesionale (83.2%).

§ Për sa i përket të qenit të kënaqur me karakteristikat e caktuara të publikimeve në dispozicion, respondentët thonë që janë shumë të kënaqur me përmbajtjen e publikimit, që ka qenë përgjigje e 58.4% të respondentëve.

§ Të pyetur se me cilat karakteristika të publikimeve janë më së paku të kënaqur, pjesa më e madhe respondentëve kanë vendosur që kjo është përmbajtja e publikimit (28.7%).

§ Pjesa dërmuese e respondentëve (98.5%) kanë treguar interes në publikimet që ofrojnë informacione të freskëta mbi ligjet aktuale dhe materialet tjera legjislative të zbatueshme në Kosovë.

§ Përderisa gati dy të tretat e respondentëve (56.3%) kanë deklaruar që do të dëshironin ta marrin këtë publikim për çdo muaj, një e katërta (25.6%) vlerësojnë që më së miri do të ishte që publikimi të distribuohej për çdo tre muaj.

§ 16.1% e respondentëve nuk kanë qenë të gatshëm të ndajnë para për lloje të tilla të publikimeve dhe thonë që publikimet duhet të distribuohen pa pagesë.

§ Diçka më pak se dy të tretat (58.3%) e klientëve potencial të publikimit mendojnë që më së miri do të ishte nëse publikimi shtpet në formë të librit.

- § Më tepër se dy e treta e respondentëve (69.3%) preferojnë publikimet me kopertina të forta.
- § Pjesa më e madhe e respondentëve (71.9%) preferojnë formatin në Microsoft Word.
- § Thjeshtësia e përdorimit dhe mundësia për të përfshirë freskimet në libër janë karakteristikat të cilat klientët i shohin si shumë të rëndësishme, dhe nga karakteristikat e ofruara të publikimit, respondentët e shohin thjeshtësinë e përdorimit si më të rëndësishmen, ku 48.2% e klientëve potencial të survejuar mendojnë që kjo është karakteristika e dorës së parë.
- § Për sa i përket gjuhës së publikimit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, respondentët kryesisht pajtohen (82.9%) që materiali duhet të botohet edhe në gjuhët tjera përveç gjuhës shqipe.
- § Për sa i përket përmbajtjes së publikimit, pjesa më e madhe e respondentëve (69.8%) vlerësojnë që nga të gjitha opsionet e ofruara, më i miri do të ishte ai që parasheh organizimin e përmbajtjes së publikimit sipas çështjeve që trajtohen.
- § Pjesa më e madhe e shfrytëzuesve potencial të survejuar të publikimit pajtohen që përmbajtja duhet të përfshijë ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga PSSP (77.9%).
- § Për sa i përket faktit që publikimi duhet të përmbajë dy lloje të indekseve: a) indeksin e përmbajtjes së materialit, dhe b) indeksin për secilin vëllim, rreth tri të katërtat e respondentëve mendojnë që të dy këto indekse do të ishin shumë të dobishme apo të dobishme.
- § Për sa i përket freskimeve që duhen përfshirë në publikim, 43.2% e respondentëve kanë thënë që do të dëshironin të marrin vetëm ligjet e ndryshuara, ndërsa mbi gjysma e respondentëve (52.3%) mendojnë që duhet të marrin botimet tërësisht të reja të ligjeve komplete.
- § Publikimi do të duhej të distribuohet përmes postës, pozicion ky i mbështetur nga 59.3% e respondentëve. Diçka më pak se një e treta e respondentëve (29.1%) thonë që do të preferonin distribuimin e publikimit personalisht tek secili. Gati çdo i dhjeti respondent ka thënë që ai apo ajo do të dëshironte që publikimi të distribuohet përmes dërgesës me veturë.

§ Për sa i përket parapagimit për publikimin që është me interes për ta, gati tri të katërtat e respondentëve (72.4%) kanë thënë që do të dëshironin të parapaguhen për publikimin.

11. Rezulatet

11.1. Përshkrimi i modelit për pjesën kuantitative të hulumtimit

Tabela 01. Përshkrimi i modelit

		Shpeshtësia	Përqindja
GJINIA	**Mashkull**	152	75%
	Femër	50	25%
MOSHA	**< 35**	49	25%
	36 - 50	79	40%
	51 >	71	36%
STATUSI I PUNËSIMIT	**I/e punësuar**	195	97%
	I/e papunë	7	3%
ARSIMIMI	**Shkolla e mesme**	7	3%
	Universiteti/kolegji i papërfunduar	11	5%
	Kolegji i përfunduar	9	4%
	Universiteti i përfunduar	151	75%
	Magjistratura/Doktorata	21	10%
	Pa përgjigje	3	1%
GRUPI ETNIK	**Shqiptar/e**	194	96%
	Të tjerë	8	4%

202 respondentë kanë marrë pjesë në këtë hulumtim. Sikur që mund të shihet në tabelë (shih Tabelën 1.), struktura gjinore e modelit ka qenë jo e rregullt dhe tri të katërtat e modelit përbëhen nga respondentë meshkuj. Për më tepër, 40% e modelit kanë qenë respondentë të moshës nga 36 në 50 vjeç, dhe një e katërta e modelit kanë qenë respondentë të moshës nën 36 vjeç, dhe 36% e respondentëve të moshës mbi 50 vjeç. Për sa i përket përbërjes së modelit dhe profesionit të respondentëve, kemi mundur të presim që pjesa më e madhe e respondentëve do të jenë të punësuar. Prandaj mund të vërejmë që 97% e respondentëve janë të punësuar ndërsa pjesa e mbetur e modelit ka qenë e përbërë kryesisht nga studentët. Për sa i përket strukturës arsimore të modelit, 75% e

respondentëve kanë të përfunduar Universitetin, 10 % kanë grada të magjistraturës apo doktoraturës, ndërsa pjesa e mbetur e modelit ka të përfunduar shkollën e mesme apo kolegjin, ose janë të angazhuar ende në procesin arsimor. Në linjë me planin e modelit, pjesa më e madhe e respondentëve kanë qenë Shqiptarë etnik (96%) ndërsa pjesa e mbetur prej 4% u takon grupeve të pakicave etnike.

Gjithashtu, është e qartë që në mesin e respondentëve ka pasur më së shumti avokatë (38%). Pjesa tjetër e modelit, për sa i përket profesionit të respondentëve, është treguar në tabelë (shih Tabelën 2.). Respondentët e punësuar në disa nga gjykatat janë pyetur se me cilin lloj të gjykatave punojnë ata. Sikur që mund të shihet, 38% e të punësuarve të survejuar të gjykatave janë të punësuar në Gjykatën komunale, 29% e respondentëve të survejuar janë të punësuar në Gjykatën e qarkut, ndërsa struktura e pjesës tjetër të modelit tregohet në tabelë.

Tabela 02. Përshkrimi i modelit

		Shpeshtësia	**Përqindja**
PROFESIONI	**Avokat**	76	38%
	Gjyqtar/e	29	14%
	Staf i gjykatës	37	18%
	Jurist	12	6%
	Staf i fakultetit juridik	6	3%
	Student i fakultetit juridik	5	2%
	Staf i Qeverisë	12	6%
	Staf i OJQ-së vendore	12	6%
	Staf i OJQ-së ndërkombëtare	12	6%
	Të tjerë	1	0%
LLOJI I GJYKATËS (N=65)	**Gjykata Supreme**	3	5%
	Gjykata e lartë për kundërvajtje	3	5%
	Gjykata komerciale	7	11%
	Gjykata e qarkut	19	29%
	Gjykata për kundërvajtje	8	12%
	Gjykata komunale	25	38%

11.2. Disponueshmëria e tanishme e publikimeve lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë dhe përmbushja e nevojave të klientëve

Pyetjet e para për respondentët që kanë marrë pjesë në pjesën kuantitative të hulumtimit kanë pasur të bëjnë me vlerësimin e disponueshmërisë së tanishme të informatave të përgjithshme lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Thuajse më tepër se gjysma e respondentëve thonë që informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë janë në dispozicion, ashtu si edhe mund të konkludohet bazuar në rezultatet e treguara grafikisht (shih grafikun 01.). Është e qartë që 40.6% e numrit të përgjithshëm të respondentëve mendojnë se informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë janë deri diku lehtësisht të arritshme, përderisa 24.8% vlerësojnë se ato janë lehtësisht të arritshme. Veç kësaj, diçka më pak se gjysma e personave të survejuar mendojnë që informatat nuk janë në dispozicion. Madje 20.3% e anëtarëve të survejuar të popullatës së klientëve potencial të publikimit të shtypur thonë që informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë nganjëherë është e vështirë të sigurohen, ndërsa 13.9% thonë që është tepër vështirë të sigurohen.

Grafiku 01. A mund të thoni që informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë janë në dispozicion?



Me analizat tjera jemi përpjekur të përcaktojmë nëse ka dallime në mes të anëtarëve të grupeve të ndryshme profesionale që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim. Analiza ka treguar që në aspektin statistikor ekziston një diferencë e konsiderueshme në mes të përgjigjeve të dhëna nga avokatët dhe të tjerët[2] (shih Grafiku 02.). Ashtu si edhe mund të shihet, ka shumë më tepër avokatë (23.7%), në raport me stafin e gjykatave (7.6%) dhe respondentët tjerë (8.3%), që vlerësojnë se informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë është vështirë të sigurohen.

Grafiku 02. A mund të thoni që informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë janë në dispozicion? (Krahasimi në mes të avokatëve, stafit të gjykatave dhe të tjerëve)



Për sa i përket disponueshmërisë së materialeve lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, respondentët që kanë marrë pjesë në pjesën kualitative të hulumtimit kryesisht vlerësojnë se materiali lidhur me këto tema është pak a shumë në dispozicion të anëtarëve të atyre profesioneve që shfrytëzojnë një material të tillë. Ende, duket që klientët potencial të publikimeve të shtypura lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë shpesh duhet të shfrytëzojnë burime të tjera, jozyrtare të informatave lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë dhe çështjet ligjore. Një nga respondentët ka përmendur që anëtarët e atyre profesioneve që bëjnë shfrytëzimin e materialeve lidhur me ligjet dhe çështjet ligjore për

[2] Grupi i respondentëve "Të tjerët" përbëhet nga respondentët e këtyre profesioneve: Jurist, staf I fakultetit juridik, staf i bibliotekës së fakultetit juridik, student i drejtësisë, staf qeveritar, staf i OJQ vendore, staf i OJQ ndërkombëtare.

qëllimet e tyre profesionale, edhepse me vështirësi të caktuara, kryesisht kujdesen vetë për sigurimin e materialit të përmendur më lartë. Përkundër faktit që ka një ofertë të pakët të publikimeve lidhur me çështjet ligjore në Kosovë, si dhe disponueshmëri të vogël të atyre materialeve, ne mund të supozojmë që profesionisti i cili shfrytëzon këto materiale për nevojat e tij apo saj, në një mënyrë do të mësohet me kushtet ekzistuese dhe do të arrijë të sigurojë të dhënat e nevojshme nën ato rrethana. Në anën tjetër, ne supozojmë që qytetarët nuk kanë qasje të mjaftueshme në informatat mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë.

> Për sa u përket ligjeve që janë në fuqi në Kosovë, mendoj që pak a shumë janë të siguruesshme. (Avokati, Gjilan)
>
> Mendoj që për ata që merren me ligjet nuk është edhe aq e vështirë të jenë të informuar për ligjet, por qytetarët janë ata që kanë vështirësi për të qenë të informuar dhe për të pasur qasje në ligjet e zbatueshme në Kosovë. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Veç kësaj kemi qenë të interesuar të shohim se në çfarë mase janë respondentët, klientët potencial të publikimeve lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, të kënaqur me disponueshmërinë e ligjeve dhe materialit tjetër të zbatueshëm legjislativ në Kosovë. Në linjë me përgjigjet e mëparshme, gati dy të tretat (64.4%) e të gjithë respondentëve të survejuar në kuadër të hulumtimit kanë thënë se janë mjaft të kënaqur me disponueshmërinë e ligjeve dhe materialit tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë (shih Grafikun 03.). Edhepse rezultatet e dhëna flasin në dobi të supozimit që respondentët janë kryesisht të kënaqur me disponueshmërinë e ligjeve dhe materialit tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, është e qartë që vetëm 9.4% e respondentëve thonë që janë plotësisht të pakënaqur me disponueshmërinë e ligjeve dhe materialit tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë.

Grafiku 03. Në çfarë mase jeni të kënaqur me disponueshmërinë e ligjeve dhe materialit tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë?



Bazuar në rezultatet e përshkruara, mund të konkludojmë se disponueshmëria e informatave mbi ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë nuk është në nivel të kënaqshëm dhe ekziston një numër i konsiderueshëm i atyre respondentëve në mesin e atyre të survejuar, që kanë dhënë gjykim negativ lidhur me disponueshmërinë aktuale të ligjeve dhe materialit tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë.

11.3. Përvojat e klientëve të publikimeve që janë në dispozicion lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë

11.3.1. Burimet në dispozicion të informatave lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë

Ne kemi qenë të interesuar të shohim çfarë përvojash kanë klientët potencial të publikimeve të shtypura lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Për sa i përket faktit që hulumtimi ka përfshirë respondentë që për hir të profesionit të tyre duhet të shfrytëzojnë disa nga burimet e informatave që janë në dispozicion lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, ne kemi bërë pyetje lidhur me burimet primare dhe sekondare të informatave. Në pyetjen rreth burimit primar të informatës lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, përgjigja më e shpeshtë ka qenë Gazeta zyrtare e UNMIK-ut, që është përmendur si burim kryesor i informatave

nga 45% të respondentëve. Në rend të dytë është publikimi në CD Rom nga ABA/CEELI (17.3%), Publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës (14.9%), dhe ueb faqja e Kuvendit të Kosovës (12.4%). Përgjigjet tjera, më pak të shpeshta, janë treguar grafikisht (shih Grafikonin 04.).

Grafiku 04. Cili është burimi primar i informatave lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë?



Analiza e mëtejme ka qenë e fokusuar në testimin e dallimeve në mes të grupeve të caktuara të respondentëve. Marrë parasysh burimet primare të informacionit që nxjerren sipas shpeshtësisë së tyre, është e qartë që ka një diferencë në mes të respondentëve të profesioneve të ndryshme (shih Grafikonin 05.). Pra, Gazeta zyrtare e UNMIK-ut përdoret më tepër nga stafi i Gjykatave (72.7%), në raport me avokatët (31.6%) dhe të tjerët (31.7%), përderisa ueb faqja e Kuvendit të Kosovës shfrytëzohet pak ose fare nga avokatët dhe stafi i gjykatave. Për sa u përket avokatëve, pjesa më e madhe e tyre (34.2%) kanë përmendur publikimin në CD Rom të ABA/CEELI si burim primar të informacionit. Në të njëjtën kohë, ky burim përdoret shumë më tepër nga avokatët, krahasuar me respondentët tjerë.

Grafiku 05. Cili është burimi primar i informacionit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë? (Krahasimi në mes avokatëve, stafit të gjykatave dhe të tjerëve)



Për sa i përket burimit sekondar të informacionit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, materiali në CD Rom nga ABA/CEELI qëndron në krye të listës (19.1%), dhe pasohet nga ueb faqja e Kuvendit të Kosovës, Gazeta zyrtare e UNMIK-ut dhe Publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës, me nga 15.1% secila (shih Grafikun 06.).

Grafiku 06. Cili është burimi juaj sekondar?



Për sa u përket publikimeve për të cilat respondentët që kanë marrë pjesë në pjesën kualitative të hulumtimit thonë se i marrin rregullisht, prapëseprapë ne kemi përshtypjen që "Gazeta zyrtare e UNMIK-ut" përdoret nga shumica e respondentëve. Është me rëndësi të theksohet që rezultatet e hulumtimit kualitativ tregojnë poashtu që ky publikim përdoret më së shumti. Përveç kësaj, duket që CD-të e publikimit të ABA-CEELI janë në mesin e atyre që gjenden në përdorim të gjerë nga profesionistët që merren me ligjin. Vlen të theksohet që disa nga respondentët thonë se nuk kanë ndonjë burim të rregullt të informacionit të cilin e shfrytëzojnë për nevojat e tyre profesionale, apo theksojnë se i shfrytëzojnë disa nga publikimet e përmendura por nuk i marrin ato rregullisht.

> Ne marrim rregullisht "Gazetën zyrtare" të UNMIK-ut dhe disa publikime të tjera nga ABA CEELI në CD, në të cilat përfshihen shumë ligje dhe rregullore. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)
>
> Nuk ka ndonjë publikim që dërgohet rregullisht në zyrën time. Unë interesohem vetë për të gjitha publikimet sikur që është "Gazeta zyrtare" e UNMIK etj. (Avokati, Suharekë)
>
> Nuk marr asnjë lloj publikimi që dorëzohet në zyrën time. Zakonisht ka disa CD të ABACEELI, por edhe këto duhet t'i gjejmë vetë.(Avokati, Gjilan)
>
> Për Gazetën Zyrtare nuk jam i sigurtë kur e marrim pasi që nuk dërgohet rregullisht, ndërsa CD-të e ABA CEELI i kemi marrë më herët por së fundi nuk kemi marrë asnjë të tillë. (stafi i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)
>
> Nuk marr asnjë lloj materiali që mbërrin rregullisht; kryesisht informohem vetë. I gjej vetë publikimet, si "Gazetën zyrtare" të UNMIK-ut ashtu edhe publikimet tjera të nevojshme për mua si avokat. (Avokati, Mitrovicë)

Të pyetur nëse marrin rregullisht ndonjë lloj publikimi lidhur me ligjet dhe materialet tjera legjislative të zbatueshme në Kosovë, saktësisht gjysma e respondentëve kanë dhënë përgjigje pozitive (shih Grafikun 07.).

Grafiku 07. A pranoni rregullisht ndonjë lloj materiali lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë?



Është përcaktuar që ekziston një diferencë e konsiderueshme statistikore në mes të grupeve të caktuara të respondentëve dhe për sa i përket profesionit të tyre. Sikur që tregohet me grafikun e mëposhtëm (shih Grafikun 08.), në aspekt statistikor, një numër më i lartë i respondentëve nga stafi i gjykatave (80.3%), në raport me avokatët (32.9%) dhe të tjerët (38.3%) pranojnë rregullisht ndonjë nga publikimet lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë.

Grafiku 08. A pranoni rregullisht ndonjë nga publikimet lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë? (Krahasimi në mes Avokatëve, stafit të gjykatave dhe të tjerëve)



Pjesa më e madhe e respondentëve që pranojnë rregullisht ndonjë nga publikimet lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, thonë që marrin Gazetën zyrtare të UNMIK-ut (68.3%). Ajo pasohet nga CD Rom të ABA/CEELI (36.6%), Publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës (31.7%), dhe publikimet tjera (shih Grafikun 09.). Për sa i përket madhësisë së modelit (N=101), nuk ka qenë e mundur të bëhet një analizë e rezultateve për kategoritë e ndryshme të respondentëve.

Grafiku 09. Cilin lloj të publikimit e merrni ju lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë?



Përgjithësisht, mund të konkludohet që nuk ka një sistem standard për dërgimin e publikimeve lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, përmes të cilit klientët e interesuar do të mund të siguronin materialin e nevojshëm lidhur me çështjet ligjore. Prandaj nuk befason fakti që një numër i konsiderueshëm i respondentëve tanë (që kanë marrë pjesë në pjesën kualitative të hulumtimit), përveç burimeve zyrtare shfrytëzojnë gjithashtu burime shtesë të informacionit lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Prandaj mund të shohim që respondentët, për nevoja të tyre profesionale shfrytëzojnë shpesh libraritë private, literaturën ligjore që e kanë mbledhur gjatë viteve të punës profesionale, si dhe Internetin.

> Unë shfrytëzoj gjithashtu bibliotekën time private, në të cilën kam mjaft materiale të ndryshme që i kam mbledhur me vite. (i punësuari i gjykatës së qarkut, Prishtinë)
>
> Zakonisht interesohem vetë për ligjet, pasi që nuk ka ndonjë publikim ku mund t'i gjejmë në një vend të gjitha materialet. (Avokati, Prishtinë)
>
> Nuk marr asnjë lloj publikimi por më duhet gjithnjë të interesohem vetë për të siguruar literaturën. Do të dëshiroja shumë që ky publikim që do të botohet të ketë një sistem efikas të dërgesës, dhe jo që avokatët t'i kërkojnë vetë këto publikime. (Avokati, Prishtinë)
>
> Mjaft shpesh shfrytëzoj bibliotekën time private për të marrë informacione rreth ligjeve. (i punësuari i gjykatës së qarkut, Prishtinë)

Respondentët që thonë se marrin rregullisht ndonjë nga publikimet lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, janë pyetur sa shpesh i marrin këto

publikime. Analiza e rezultateve është bërë për tri nga publikimet që përdoren më së tepërmi. Tabela tregon (shih Tabelën 03.) që pjesa më e madhe e respondentëve që shfrytëzojnë Gazetën zyrtare të UNMIK-ut e marrin këtë publikim një herë në muaj (37.7%) dhe për çdo tre muaj (30.4%). Për sa i përket publikimit të ABA/CEELI në CD Rom që është thënë se shfrytëzohet nga 37 respondentë, rreth një e treta e respondentëve kanë thënë se e marrin këtë publikim një herë në vit (32.4%), ndërsa të tjerët për çdo tre muaj (27%). Për sa i përket Publikimit të Qendrës Juridike të Kosovës, që është thënë se pranohet rregullisht nga 32 respondentë, distribuimi i rezultateve tregon që ky publikim nuk ka ndonjë vazhdimësi të rregullt të distribuimit tek klientët.

Tabela 03. Sa shpesh i pranoni publikimet lidhur me ligjet dhe materialet tjera legjislative të zbatueshme më Kosovë?

	Gazeta zyrtare e UNMIK-ut (N=69)	**ABA/CEELI, CD Rom** (N=37)	**Publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës** (N=32)
Çdo muaj	37.7%	16.2%	25.0%
Çdo tre muaj	30.4%	27.0%	21.9%
Një herë në vit	4.3%	32.4%	21.9%
Tjetër	11.6%	16.2%	18.8%
ND/REFUZON	15.9%	8.1%	12.5%

Më tej kemi qenë të interesuar të shohim se çfarë shume të hollash klientët potencial të publikimeve të shtypura lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, do ta ndanin për publikimet aktualisht në dispozicion, për të cilat është mësuar që shfrytëzohen më së tepërmi. Bazuar në rezultatet (shih Tabelën 04.) mund të vërejmë që pjesa më e madhe e publikimeve për shumicën e respondentëve janë pa pagesë, dhe shuma maksimale e të hollave të cilën klientët e publikimit e ndajnë për këtë qëllim nuk kalon shumën prej 10 Eurosh.

Tabela 04. Sa paguani për këtë publikim?

	Gazeta zyrtare e UNMIK-ut N=69)	**ABA/CEELI, CD Rom** (N=37)	**Publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës** (N=32)
Është pa pagesë	82.6%	94.6%	87.5%
Më pak se 5 Euro	7.2%	0.0%	3.1%
Në mes 5 dhe 10 Euro	2.9%	0.0%	6.3%
Në mes 10 dhe 15 Euro	0.0%	0.0%	0.0%
Më tepër se 15 Euro	0.0%	0.0%	0.0%
DK/REFUZIM	7.2%	5.4%	3.1%

Klientët e publikimeve në dispozicion lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë janë pyetur se në çfarë mase janë të kënaqur me publikimet që mund të sigurohen. Klientët janë kryesisht të kënaqur me publikimet lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, meqë tre nga katër respondentë (77.2%) thonë që janë mjaft të kënaqur me publikimet në dispozicion (shih Grafikun 10.). Thuajse një e pesta e respondentëve (18.8%) thonë megjithatë që janë pak a shumë të pakënaqur me publikimet në dispozicion lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë.

Grafiku 10. Në çfarë mase jeni të kënaqur me publikimet lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë të cilin e pranoni ju?



Respondentët që kanë marrë pjesë në pjesën kualitative të hulumtimit dhe që marrin rregullisht disa nga publikimet që janë në dispozicion lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, janë kryesisht të pakënaqur me atë që ofrojnë këto publikime. Pra mund të shohim që ankesat e respondentëve tanë kanë të bëjnë kryesisht me përmbajtjen si dhe me formatin e publikimit. Për sa i përket përmbajtjes së publikimit, respondentët theksojnë që nuk janë të kënaqur me këtë karakteristikë të publikimit dhe me faktin që ajo nuk i plotëson nevojat e tyre profesionale, pa bërë megjithatë elaborimin e mangësive. Ata kanë theksuar gjithashtu problemin e gabimeve gramatikore në këto publikime. Për sa i përket llojit të çështjeve që trajtohen në këto publikime, gabimet gramatikore dhe gabimet e shtypit shumë lehtë mund të ndërrojnë kuptimin e tekstit të shkruar, prandaj respondentët që kanë marrë pjesë në hulumtimin kualitativ mendojnë që këto mangësi duhet të shmangen në krijimin e publikimeve të këtij lloji.

> Jam mjaft i zhgënjyer madje edhe me përmbajtjen e këtij publikimi, mënyrën e botimit e gjithashtu edhe mbështjellësin e tij. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Këto lloje të botimeve mjaft shpesh përmbajnë në vete shumë gabime gramatikore, pasi që e dimë që edhe gazetat ditore madje kanë shumë gabime gramatikore. (i punësuari i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë)

> Dua të theksoj një problem tjetër tepër të madh sa i përket Gazetës Zyrtare që botohet. Normalisht që publikimet që botohen nga Institucionet nuk do të duhej të kishin gabime gramatikore apo në përmbajtjen e tyre dhe "Gazeta zyrtare" e UNMIK-ut i ka të dyja këto mangësi. Së këndejmi, mendoj që zyrtarët duhet të jenë të kujdesshëm me rastin e publikimit të materialeve ligjore, pasi që vetëm me një fjalë të vetme mund të ndryshojë kuptimi i fjalisë dhe përmbajtja e tekstit dhe kështu do të kemi pasoja negative për shoqërinë. (Avokati, Suharekë)

> Kur flasim për përmbajtjen atëherë kemi të bëjmë me një temë mjaft të komplikuar, dhe sa i përket përmbajtjes së ligjeve, flas në cilësi të ekspertit ligjor, nuk jam fare i kënaqur. (Avokati, Mitrovicë)

> Sa i përket përmbajtjes së këtyre publikimeve, do të thosha që nuk jam aq i kënaqur. Ato mund të jenë më të mira dhe shpresoj që në një të ardhme të afërt situata do të ndryshojë. (Prokurori, Prizren)

Respondentët kanë theksuar një problem mjaft specifik për sa u përket publikimeve me përmbajtje të tillë. Nganjëherë ngjan që përmbajtja e publikimit, që në rend të parë i referohet "Gazetës zyrtare" të UNMIK-ut, nuk është mjaft e kuptueshme për klientët, që shpjegohet me përkthimet joadekuate të tyre. Respondentët supozojnë që kjo është rezultat i angazhimit të përkthyesve të pa kualifikuar, që nuk e njohin sa duhet terminologjinë ligjore. Përkthimi jo adekuat mund të ndërrojë në tërësi domethënien dhe kuptimin e materialit, dhe kjo e bën atë të papërdorshëm për klientët. Poashtu, përdorimi i materialeve të tilla kërkon angazhim shtesë nga klientët për ta kontrolluar atë dhe eventualisht për të korrigjuar përkthimin. Prandaj, respondentët që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim theksojnë që përkthimi do të duhej bërë ekskluzivisht nga përkthyesit me njohuri të mira të çështjeve dhe terminologjisë juridike/ligjore.

> Më duhet të theksoj që ka mjaft gabime në këto publikime, pasi që për të kuptuar ligjin duhet të lexoni shumë dhe në fund mund të ngjajë që nuk do të kuptoni asgjë. Mendoj që problemi qëndron tek përkthyesit që nuk dijnë të bëjnë përkthimin e duhur të ligjeve dhe nuk njohin terminologjinë ligjore. Në përgjithësi mendoj që përkthimi i ligjeve është mjaft i dobët. (Avokati, Gjilan)

> Do të doja të ndalem paksa tek përkthimi i këtyre publikimeve zyrtare. Të gjitha përkthimet janë mjaft të dobëta. Mund të vëreni që Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës janë përkthyer nga tre apo katër përkthyes të ndryshëm, pasi që në tekste përdoren shprehje të ndryshme për fjalë të njëjta. (Avokati, Prishtinë)

> Pikësëpari, sa i përket "Gazetës zyrtare" ajo që nuk më pëlqen është përkthimi, sepse po të bëjmë një krahasim në mes të versionit në gjuhën angleze dhe atij në gjuhën shqipe, mund të gjejmë shumë gabime sepse përkthyesit që bëjnë përkthimet e materialit, për aq sa di unë nuk kanë të bëjnë asgjë me ligjet dhe çështjet ligjore. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Për sa i përket distribuimit të publikimeve lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, respondentët vlerësojnë që situata nuk është e kënaqshme. Edhepse ka disa respondentë që thonë se i marrin disa nga publikimet rregullisht, numri më i madh i respondentëve thekson që mënyra në të cilën bëhet distribuimi i publikimeve tek klientët nuk është e sigurtë. Prandaj respondentët thonë që nuk mund të mbështeten në distribuimin e publikimeve dhe sistemin e dërgimit së tyre, që përsëri i referohet kryesisht publikimit të "Gazetës zyrtare" të UNMIK-ut. Ngjan mjaft shpesh që dërgimi i publikimit bëhet me vonesë krahasuar me atë që pritet në këtë rast dhe në raport me nevojat e klientit. Poashtu, institucionet tek të cilat bëhet distribuimi i rregullt i publikimeve, nganjëherë nuk marrin numrin e mjaftueshëm të kopjeve për të gjithë klientët. Prapëseprapë, mund të vërejmë që disa nga klientët janë të kënaqur me distribuimin, që shpie në supozimin se çështja e regjistrimit të shfrytëzuesve të publikimit dhe vet distribuimi i publikimeve nuk është e zgjidhur në mënyrë sistematike.

> Kryesisht informohem për ligjet e zbatueshme në Kosovë nga "Gazeta zyrtare" e UNMIK-ut. Sistemi i shpërndarjes është mjaft i dobët, pasi që ata nuk kanë ndonjë sistem të koordinuar të shpërndarjes (Avokati, Suharekë)

> Kur flasim për ligjet e zbatueshme, kur jam regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës kur edhe kam paguar shumën prej 560 Euro, më ishte premtuar që ata do të bëjnë dërgimin e të gjitha materialeve të nevojshme, por as pas tre muajsh nuk kam marrë ende asnjë lloj publikimi nga Oda e Avokatëve të Kosovës. (Avokati, Mitrovicë)

> Publikimi zyrtar zakonisht dërgohet përmes Zyrës Postare, por në shumë raste ato nuk dërgohen në kopje të mjaftueshme. Duhet të merret parasysh numri i kopjeve që dërgohen, për shembull në Zyrën e Prokurorisë publike të qarkut në Prizren jemi 7 prokurorë dhe do të ishte mirë që publikimi të dërgohet në po aq kopje. (Prokurori, Prizren)

> Të gjitha publikimet i marrim me kohë. Zakonisht kur mbërrijnë ato këtu në Gjykatën e Qarkut në Pejë, Administratori na i dorëzon ato me kohë. Kjo është arsyeja pse jam i kënaqur me shpërndarjen e tyre. (Gjyqtari, Pejë)

> Tani kemi "Fletoren zyrtare" që është mjaft e dobishme por ende nuk është filluar me shitjen dhe ne nuk mund ta blejmë atë. Do të ishte mirë po të sigurohej ajo për personat që merren me ligjet dhe që e shfrytëzojnë "Fletoren" në praktikë. Kam pyetur në shumë vende, si në Fakultetin e Drejtësisë, Institutin Gjyqësor, në Shoqatën e Gjyqtarëve të Kosovës, por nuk kanë mundur të më sigurojnë një kopje të "Fletores". (Avokati, Prishtinë)

Më tej kemi qenë të interesuar të mësojmë nëse respondentët parapaguhen apo paguajnë për ndonjë bazë të të dhënave online. Siç mund të shihet (shih Grafikun 11.), një numër tepër i vogël i respondemtëve kanë thënë që shfrytëzojnë lloje të tilla të publikimeve. Në

mesin e publikimeve që ofrohen online, paraqitet baza e të dhënave GTZ dhe 8.5% të respondemtëve thonë që janë të parapaguar për atë publikim apo e blejnë atë.

Grafiku 11. A jeni të parapaguar apo a paguani për cilëndo bazë online të të dhënave, sikur që është …?



11.3.2. Karakteristikat e rëndësishme të publikimeve në dispozicion lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë

Në kuadër të analizës së bërë për cilësinë e publikimeve në dispozicion lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, kemi qenë të interesuar të mësojmë se në çfarë mënyre respondentët bëjnë vlerësimin e karakterisitikave të caktuara të publikimeve dhe çfarë rëndësie u japin karakteristikave të caktuara kur bëjnë përzgjedhjen e publikimit. Lidhur me këtë, pyetja e parë që u kemi bërë respondentëve ka qenë të definojnë se cila karakteristikë në mesin e opsioneve të ofruara është më e rëndësishme në përzgjedhjen e publikimit të cilin ata e marrin apo e blejnë. Sikur që mund të shihet (shih Grafikun 12.) respondentët që kanë marrë më herët disa nga publikimet që janë në dispozicion, vlerësojnë që përmbajtja e publikimit ka qenë karakteristika më e rëndësishme në zgjedhjen e publikimit të cilin ata do ta kishin porositur ose blerë për nevojat e tyre profesionale. 83.2% e respondentëve kanë shfaqur këtë pozicion. Një numër më i vogël i respondentëve kanë deklaruar që faqosja apo stili i

publikimit ka qenë karakteristika më e rëndësishme për blerjen apo porositjen e publikimit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë (10.9%), si dhe freskimet e rregullta të publikimit (2%).

Grafiku 12. Kur ju (zyra juaj) bëni zgjedhjen e publikimit që do ta merrni apo bleni, cila është karakteristika më e rëndësishme?



Për sa i përket të qenit të kënaqur me karakteristikat e caktuara të publikimeve që ata shfrytëzojnë, respondentët kanë thënë që më shumë janë të kënaqur me përmbajtjen e publikimit, përgjigje kjo e dhënë nga 58.4% e respondentëve (shih Grafikun 13.). Pason faqosja apo stili i publikimit (9.9%), dhe freskimi i rregullt i publikimit (8.9%).

Grafiku 13. Nga publikimet ligjore të Kosovës të cilat i merrni ju, me cilat karakteristika është më e kënaqur zyra juaj?



Nëse krahasojmë nevojat që klientët potencial i kanë lidhur me karakteristikat e caktuara që janë përshkruar përmes vlerësimit të rëndësisë së karakteristikave, me vlerësimin e të qenit të kënaqur me ato karakteristika, mund të vërehet një mospërputhje e konsiderueshme për sa i përket njërës nga karakteristikat – përmbajtjes së publikimit. Mund të shohim (shih Grafikun 14.) që niveli i kënaqësisë me këtë karakteristikë të publikimeve që janë në shfrytëzim, në aspektin statistikor është më e ulët nga rëndësia të cilën respondentët i kushtojnë po të njëjtës karakteristikë kur bëjnë zgjedhjen e publikimit.

Kjo mund të shërbejë si bazë për të konkluduar që ka publikime të cilat nuk i përmbushin nevojat e klientëve. Mund të vërejmë gjithashtu që përmbajtja e publikimit, që konsiderohet si karakteristika më e rëndësishme e publikimit, është njëkohësisht një karakteristikë që mund të përmirësohet më tej me qëllim që klientëve t'u ofrojë shërbimin që do të plotësojë në tërësi nevojat dhe kërkesat e tyre.

Grafiku 14. Kur ju (zyra juaj) bëni zgjedhjen e publikimit që do ta merrni apo bleni, cila është karakteristika më e rëndësishme / Nga publikimet ligjore të Kosovës të cilat i merrni ju, me cilat karakteristika është më e kënaqur zyra juaj?



Përgjigjet e dhëna në pyetjen vijuese konfirmojnë konkludimet e mëparshme. Në të vërtetë, të pyetur se me cilën karakteristikë të publikimit që ju e merrni jeni më pak të kënaqur, pjesa më e madhe e respondentëve ka thënë që kjo është përmbajtja e publikimit (28.7%). Kjo pasohet nga përgjigjet tjera (shih Grafikun 15.), ku për freskimin e rregullt të publikimit, 27.7% të klientëve të survejuar të publikimeve që janë në dispozicion, thonë që janë më së paku të kënaqur.

Grafiku 15. Nga publikimet ligjore të Kosovës të cilat ju i merrni, me cilat karakteristika është më së paku e kënaqur zyra juaj?



11.4. Nevojat e klientëve potencial të publikimeve lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë

11.4.1. Interesimi për publikimet e shtypura lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë

Në vazhdim kemi elaboruar një vlerësim lidhur me nevojat e klientëve. Respondentëve u është thënë fillimisht që të supozojnë se ekziston publikimi që do të ofrojë informacione të freskëta për të gjitha ligjet e tanishme dhe materialet tjera legjislative të zbatueshme në Kosovë. Më pas respondentët janë pyetur nëse dëshirojnë të marrin rregullisht këtë publikim. Sikur që mund të shihet (shih Grafikun 16.) pjesa dërrmuese e respondentëve (98.5%) kanë treguar interesim në një lloj të tillë të publikimit. Pa marrë parasysh profesionin e tyre, respondentët janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje.

Grafiku 16. A do të dëshironit të merrni rregullisht këtë publikim?



Në përputhje me konkludimet e mëhershme që lënë të kuptohet se disponueshmëria dhe cilësia e publikimeve lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë është në nivel të ulët, mund të supozojmë që respondentët që kanë marrë pjesë në pjesën kualitative të hulumtimit, si klientë potencial të publikimeve të shtypura, do të tregonin interesim në publikimin që u përgjigjet plotësisht nevojave të tyre për informacione që lidhen me

profesionin e tyre. Padyshim që ekziston hapësirë në tregun e publikimeve të këtij lloji në Kosovë që do të siguronte qasje për përdoruesit potencial në të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

> Unë kam shumë besim në këtë publikim dhe mendoj që publikimi do të ketë efekte pozitive. Por problemi këtu është si t'u ofrohet ky publikim njerëzve që kanë nevojë për të. (Avokati, Suharekë)
>
> Mendoj që publikimi i materialit ligjor është ide e shkëlqyer. Është çështje teknike çfarë do të jetë ky publikim apo si do të duket, apo vëllimi që do ta ketë etj. (Avokati, Mitrovicë)
>
> Së pari shpresoj që ky lloj publikimi do të jetë më i plotë dhe përmbajtja e tij të jetë më e pasur me materiale, pasi që vetë ideja që ne "stafi i gjykatave" të gjejmë në një publikim gjithë atë që na duhet, të bën të ndjehesh shumë mirë. (Edhepse mendoj që kjo është e pamundur) (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Duke folur më tej për publikimet që zgjojnë interesimin e tyre, gati dy të tretat e respondentëve (56.3%) kanë thënë që këtë publikim do të dëshironin ta marrim një herë në muaj. Rreth një e katërta (25.6%) e respondentëve kanë thënë që do të preferonin distribuimin e publikimit për çdo tre muaj (shih Grafikun 17.).

Grafiku 17. Sa shpesh do të dëshironit ta merrni këtë publikim?



11.4.2. Çmimi i publikimit

Për sa i përket çmimit të publikimeve, opinionet e klientëve potencial kanë qenë mjaft të ndara. Sikur që mund të shihet (shih Grafikun 18.) 16.1% e respondentëve nuk janë të gatshëm të ndajnë të holla për një lloj të tillë publikimi dhe mendojnë që distribuimi duhet bërë pa pagesë. Në mesin e respondentëve që mendojnë se e vlen të paguhet për publikimin, gjysma e tyre do të paguanin jo më tepër se 5 Euro (28.1%) ndërsa (24.1%) jo më tepër se 10 Euro. Ndërsa 12.1% e respondentëve kanë thënë që janë të gatshëm të paguajnë mbi 15 Euro.

Nëse marrim parasysh që pjesa më e madhe e respondentëve i marrin pa pagesë publikimet që aktualisht janë në dispozicion, është paksa befasuese që një numër jashtëzakonisht i vogël i tyre do të ishin të gatshëm të ndajnë të holla për një lloj të tillë të publikimit. Kjo mbase mund të arsyetohet me pakënaqësinë e identifikuar të tyre për sa u përket publikimeve që aktualisht janë në dispozicion.

Grafiku 18. Sa do të ishit të gatshëm të paguani për këtë publikim?

N=202



Analiza e mëtejme tregon ekzistencën e dallimeve ndër-grupore varësisht nga profesioni i respondentëve. Pra, mund të shohim (shih Grafikun 19) që në aspektin statistikor, një numër konsiderueshëm më i lartë i respondentëve të kategorisë "të tjerët" (45%), në

krahasim me avokatët (16.4%), dhe stafin e gjykatave (31.8%) thonë që do të ishin të gatshëm të paguajnë jo më tepër se 5 Euro për këtë publikim.

Grafiku 19. Sa do të ishit të gatshëm të paguani për këtë publikim? (Krahasimi në mes të avokatëve, stafit të gjykatave dhe të tjerëve)



Për sa i përket çmimit të publikimit lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, opinionet e respondentëve pjesëmarrës në hulumtimin kualitativ ndryshojnë mjaft. Në një anë, disa nga respondentët mendojnë se nëse publikimi vërtetë i përmbushë nevojat e tyre profesionale, do të ishte e vlefshme të ndahen të holla për atë qëllim. Madje edhe ata respondentë që kanë përmendur statusin e pafavorshëm financiar të popullatës së Kosovës në përgjithësi, kanë thënë që janë të gatshëm të paguajnë një shumë të arsyeshme për publikimin lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

> Unë shpesh paguaj për publikimet që i marr, dhe normalisht që do të paguaj për këtë publikim por me një kusht, që ky publikim i ri të jetë më praktik për përdorim. (Avokati, Suharekë)

> Sa për paratë, mendoj që nuk është edhe aq problem kjo, pasi që më pëlqen të mbledh materiale të ndryshme që më nevojiten dhe nëse ky publikim përmban materiale të mira, atëherë do të paguaj pa ndonjë problem. Kjo është më tepër diç teknike. (Avokati, Mitrovicë)

> Edhe pse bashkë me kolegët marrim një pagë minimale, jam në gjendje të paguaj. (Gjyqtari, Pejë)

> Për publikimet që ne i marrim nuk jam i informuar nëse i paguajmë ato, por mendoj që ato janë pa pagesë, dhe për mua personalisht nuk do të jetë ndonjë problem të paguaj pasi që më pëlqen të kem tërë literaturën që lidhet me punën time. (I punësuari i Gjykatës së qarkut, Prishtinë)

> Por duhet të kemi parasysh që çmimi duhet të jetë i arsyeshëm për shkak të situatës së rëndë ekonomike në Kosovë. (Avokati, Gjilan)

Në anën tjetër, ka pasur respondentë që kanë thënë se nuk janë të gatshëm të ndajnë mjete për publikimin, duke e shpjeguar këtë qëndrim me pozitën e rëndë financiare në të cilën gjenden. Poashtu, duket se profesionistët që do të mund ta shfrytëzonin publikimin lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë për qëllime të aktiviteteve të tyre të punës, mendojnë që institucionet, organizatat apo kompanitë do të duhej të sigurojnë apo të blejnë publikimin dhe kjo nuk do të duhej të ishte obligim i individit. T'u kujtojmë edhe njëherë konkludimet e nxjerra nga hulumtimi kuantitativ. Në të vërtetë, tri të katërtat e respondentëve kanë thënë që do të ishin të gatshëm të paguajnë për publikimin që do të ofronte informata mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë.

> ...Do të thoja që për shkak të pagave të vogla që kemi, nuk do të ishim në gjendje të paguanim as edhe një euro për këto publikime. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Nëse Gjykata e Qarkut i mbulon shpenzimet mendoj që nuk do të ketë fare problem, por nëse do të duhej të paguajmë individualisht, mendoj që personalisht nuk do të mund të paguaj atë çmim, pasi që nëse krahasohet puna e madhe që bëjmë, pagat tona janë shumë të vogla. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Zakonisht deri tani nuk kam paguar asgjë për këto publikime, pra kanë qenë pa pagesë, si për shembull "Gazeta zyrtare", publikimi i Qendrës Juridike të Kosovës, materialet që janë siguruar në seminare. Mbase do të paguaj një shumë të vogël të hollash por nuk mund të paguaj nëse çmimi është më i lartë. (Avokati, Prishtinë)

11.4.3. Formati i publikimit

Pikësëpari, kemi qenë të interesuar të mësojmë se cila formë e publikimit do të ishte më e pëlqyeshme për respondentët. Diç më pak se dy të tretat (58.3%) e klientëve potencial të publikimit mendojnë që do të ishte më së miri sikur publikimi të shtypej në formë të libirit (shih Grafikun 20.). Përderisa një numër shumë i vogël i respondentëve (3%) kanë treguar interes në formën e internetit për publikimin, mesatarisht çdo i pesti respondent (18.1%) vlerëson që publikimi duhet të jetë në CD-ROM. Një e pesta e respondentëve (20.6%) thonë që opsioni më i pranueshëm do të ishte përgatitja e publikimit në të gjitha format e përmendura më lartë.

Grafiku 20. Në cilën formë do të dëshironit të ishte ky publikim?



Për sa i përket formatit të publikimit në të cilin kanë treguar interesim klientët, pjesa më e madhe e respondentëve pjesëmarrës në pjesën kualitative të hulumtimit kanë thënë poashtu që do të dëshironin që publikimi lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë të jetë në formë të librit. Ky format tradicional i publikimit konsiderohet si më i përshtatshëm dhe më praktik nga të tjerët. Megjithatë, respondentët theksojnë që ky format i publikimit do të ishte i dobishëm nëse do të plotësonte standardet e cilësisë që janë identifikuar si të rëndësishme në intervistë. Kjo kryesisht ka të bëj me thjeshtësinë e përdorimit të librit apo publikimit. Në anën tjetër, disa nga respondentët preferojnë formatin në CD të publikimit, që në këtë rast shihet si një burim i thjeshtë, praktik, i kuptueshëm dhe afatgjatë i informacionit mbi ligjet e zbatueshme në Kosovë. Si shembull pozitiv përmendet "CD e ABA CEELI", për të cilën klientët thonë që është dizajnuar në mënyrën e duhur dhe paraqet një model që do të mund të merrej parasysh në përgatitjen e publikimit të ri. Disa nga respondentët preferojnë përgatitjen e publikimit në disa formate të ndryshme, kryesisht në formë libri dhe në CD. Vlen të përmendet që publikimi në formë të librit është vlerësuar si forma më e dëshirueshme madje edhe në hulumtimin kuantitativ.

> Libri do të ishte i mirë nëse është i përdorshëm lehtë dhe jo i komplikuar. (Avokati, Suharekë)
>
> Do të preferoja këtë publikim në formë libri. (Avokati, Gjilan)
>
> Së pari libri duhet të jetë praktik, i përdorshëm lehtë, dhe jo një libër që nuk mund ta kuptoni. (Avokati, Mitrovicë)

Ky publikim do të ishte i mirë si libër, pasi që librin mund ta merrni me vete kudo. Është i lehtë për përdorim. (Gjyqtari, Pejë)

Do të ishte mirë që ky publikim të jetë edhe në CD, Internet dhe si libër. Personalisht më tepër preferoj librin. Pasi që librat janë më praktik, që nga fillimi jam mësuar më tepër me librat. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Për mua është njësoj si libri ashtu edhe CD. E kam përmendur më herët që tani jemi mësuar me CD-të e ABA-CEELI prandaj nuk e kam problem. (Avokati, Prishtinë)

Nëse publikimi do të jetë në CD kjo është diç tjetër, për shembull ngjan shpesh që CD-të janë të dëmtuara dhe nuk janë aq të sigurta. Nëse do të jenë në CD, do të doja të ishin sikur "CD-të e ABA-CEELI ". (Gjyqtari, Pejë)

Dua të theksoj që jam i kënaqur me CD-të e ABA-CEELI pasi që janë në version elektronik dhe të lehta për përdorim. Dhe është shumë e lehtë kur i keni të gjitha materialet në një vend dhe nuk keni nevojë të lexoni dhe të kërkoni në libra të ndryshëm. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Them se publikimi në CD është më i përshtatshëm por edhe kopja e librit nuk do të ishte ide e keqe. Për shkak të rrethanave në të cilat jetojmë, ka mjaft raste kur nuk mund të përdorim kompjuterin, prandaj them se publikimi duhet të jetë edhe në formë libri. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Do të ishte mirë që të publikohej si libër e gjithashtu edhe në versionin elektronik, pasi që tani të gjithë kemi kompjuterë dhe nuk është vështirë të përdoren. (Avokati, Suharekë)

Lidhur me formën e publikimit, respondentët janë pyetur për kopertinën në të cilën do të duhej shtypur publikimi (shih Grafikun 21.). Më tepër se dy të tretat të respondentëve (69.3%) preferojnë kopertinat e forta. 11.6% e respondentëve preferojnë opsionin e kopertinës së butë. 7.5% e respondentëve nuk kanë vendosur për këtë pyetje.

Grafiku 21. Do të preferonit kopertinën e fortë apo të butë?



Një numër më i vogël i respondentëve pjesëmarrës në pjesën kualitative të hulumtimit e kanë përmendur kopertinën e publikimit lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Respondentët që mendojnë se publikimi duhet të jetë në formë libri, vlerësojnë që cilësia e kopertinës duhet të merret gjithashtu parasysh. Pasi që publikimi do të ishte në përdorim të vazhdueshëm nga klientët, respondentët vlerësojnë që kopertina e fortë është më e përshtatshme dhe do të siguronte një përdorim më afatgjatë të publikimit. Përveç kësaj, ka pasur respondentë që nuk e shohin këtë karakteristikë si të rëndësishme dhe që kanë thënë se të siguruarit e përmbajtjes cilësore të publikimit do të duhej kushtuar vëmendje e posaçme.

> Është mirë që e bëni këtë pyetje, dhe unë do të doja ta kem publikimin me kopertinë të fortë dhe jo sikur Gazeta zyrtare e UNMIK-ut që pas një muaji dëmtohet dhe nuk mund ta përdorim por duhet prapë të bëjmë kopjet e saj. Për këtë arsye, do të të ishte shumë mirë po të ishte në kopertinë të fortë, madje edhe duken më bukur. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Sa i përket kopertinës, mendoj që kjo nuk është aq relevante pasi më e rëndësishme është përmbajtja e publikimit. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Më tej, nga të gjitha karakteristikat e përmendura të cilat i kemi diskutuar me respondentët, duket që thjeshtësia është vlerësuar si gjëja më e rëndësishme. Në të vërtetë, respondentët theksojnë që është me rëndësi që përmbajtja e publikimit të jetë e organizuar në mënyrë të thjeshtë, që do të mundësonte përdorimin sa më të mirë nga klientët.

Që një publikim të jetë i afërt për lexuesin, pikësëpari duhet të jetë sa më i lehtë për përdorim. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Mendoj që është shumë me rëndësi që ky publikim të përfshijë materiale të ndryshme që do të jenë të lehta për përdorim praktik nga gjykatat, prokurorët dhe avokatët. (Avokati, Prishtinë)

Është e ditur që libri duhet të jetë lehtë i përdorshëm ndërsa çmimi nuk është edhe aq me rëndësi. (Prokurori, Prizren)

Më tej kemi qenë të interesuar të mësojmë se cili format elektronik do të ishte më i përshtatshëm për klientët. Mund të shohim (shih Grafikun 22.) që shumica e respondentëve (71.9%) preferojnë formatin Microsoft Word; ndërsa një numër më i vogël i respondentëve mendojnë që duhet shfrytëzuar formatet tjera, të përmendura si më poshtë.

Grafiku 22. Nëse këto publikime do të ishin në dispozicion në formë elektronike, cili është formati më i mirë për shfrytëzim nga ju (zyra juaj)?



Për sa i përket formatit elektronik të publikimit, respondentët pjesëmarrës në pjesën kualitative të hulumtimit kryesisht preferojnë programin Microsoft Word. Duket që ky program për leximin dhe redaktimin e tekstit është në përdorim të gjerë nga shfrytëzuesit e kompjuterit, prandaj edhe klientët potencial janë të mësuar me të dhe është më i afërt për shumicën e tyre. Poashtu, respondentët pjesëmarrës në pjesën kualitative të hulumtimit mendojnë që programi Adobe do të mund të përdorej gjithashtu për këtë

qëllim pasi që pamundëson bërjen e ndryshimeve në tekstin e shkruar, që marrë parasysh çështjen në diskutim, shihet si një gjë me rëndësi.

> Personalisht nuk kam ndonjë problem me përdorimin e kompjuterit prandaj në çfarëdo forme që të jetë publikimi, për mua nuk do të ketë asnjë telashe. Zakonisht publikimet në internet ofrohen në Adobe, por pasi që nuk kam probleme me përdorimin e kompjuterit, nuk është me rëndësi softueri që përdoret për publikimin. (stafi i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë)

> Zakonisht punoj me programin Word, por mendoj që Adobe është më i përshtatshëm pasi që nuk mund të manipuloni me përmbajtjen e teksteve ligjore. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Do të ishte mirë ta kemi publikimin në versionin elektronik, për vete do të preferoja programin Word pasi që këtë program e shfrytëzoj më tepër. (Avokati, Prishtinë)

> Unë shfrytëzoj programin Word dhe do të doja që ky publikim të jetë në Word. (Avokati, Suharekë)

> Dhe nëse do të jetë në versionin elektronik, do të preferoja më tepër të jetë në Word pasi që di ta përdorë atë më mirë. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

11.4.4. Karakteristikat e favorshme të publikimit

Lidhur me publikimet për të cilat respondentët kanë treguar interesim, kemi qenë të interesuar të mësojmëse çfarë rëndësie u kushtojnë respondentët karakteristikave të caktuara të publikimit. Sikur që mund të shohim në tabelë (shih Tabelën 05.) thjeshtësia e përdorimit dhe mundësia për të bërë freskime në libër janë karakteristika që respondentët i shohin si shumë të rëndësishme. Prandaj, gati katër të pestat e respondentëve kanë thënë që këto karakteristika do të ishin më të rëndësishmet në rast se do ta shfrytëzonin publikimin. Çmimi është një karakteristikë e rëndësishme e publikimit për më tepër se gjysmën e klientëve potencial (55.3%). Edhepse 39.7% e respondentëve thonë që stili i publikimit nuk është me rëndësi, gati gjysma e respondentëve e shohin këtë si një karakteristikë me rëndësi (17.1%), ndërsa deri diku të rëndësishme (26.1%).

Tabela 05. Për blerjen e këtij publikimi nga ju (zyra juaj), sa e rëndësishme do të ishte karakteristika në vijim? (N=199)

	Mundësia për futjen e freskimeve në tekst	E bukur për ekspozim në bibliotekën tuaj	Çmimi i arsyeshëm	Lehtësia e përdorimit
Shumë e rëndësishme	77.9%	17.1%	54.3%	78.9%
Deri diku e rëndësishme	9.0%	26.1%	23.6%	10.6%
Deri diku e parëndësishme	7.0%	11.6%	15.1%	6.5%
E parëndësishme	3.0%	39.7%	5.0%	4.0%
ND/REFUZIM	3.0%	5.5%	2.0%	0.0%

Në linjë me konkludimet e mëhershme, respondentët kanë zgjedhur thjeshtësinë e përdorimit si një nga karakteristikat më të rëndësishme të publikimit dhe 48.2% e klientëve potencial e përkrahin këtë karakteristikë (shih Grafikun 23.). Më pas vie "mundësia për futjen e freskimeve në libër" që 36.2% e respondentëve e konsiderojnë si cilësinë më të rëndësishme.

Grafiku 23. Cila do të ishte karakteristika më e rëndësishme e këtij publikimi?



Për sa i përket gjuhës së publikimit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, respondentët kryesisht pajtohen (82.9%) që materiali duhet të

publikohet edhe në gjuhë tjera përveç gjuhës Shqipe. Diç më pak se një e pesta e respondentëve (16.6%) mendojnë që publikimi duhet të përgatitet vetëm në gjuhën Shqipe (shih Grafikun 24.).

Grafiku 24. A do të preferonit që publikimi të jetë vetëm në gjuhën Shqipe apo edhe në gjuhët tjera?



Respondentët që mendojnë se publikimi duhet të përgatitet edhe në gjuhët tjera përveç gjuhës Shqipe, tregojnë edhe cilat gjuhë do të duhej të jenë këto. Përgjigja më e shpeshtë ka qenë gjuha Angleze dhe 82.5% e respondentëve pajtohen që gjuha angleze do të duhej përdorur si një nga gjuhët e publikimit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë (shih Grafikun 25.). Diç më pak se një e katërta e respondentëve kanë thënë që publikimi duhet përgatitur edhe në gjuhën serbe (70.5%), ndërsa një e katërta e respondentëve mendojnë që publikimi duhet të jetë edhe në gjuhën boshnjake (24.1%).

Grafiku 25. Në cilat gjuhë duhet përgatitur publikimi?



Për sa i përket gjuhës në të cilën do të duhej përgatitur publikimi lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, hulumtimi kualitativ ka shfaqur një seri të qëndrimeve të ndryshme. Përgjithësisht, mbizotëron qëndrimi që publikimi duhet të sigurohet në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës, që janë gjuha shqipe dhe ajo serbe. Sidoqoftë, marrë parasysh problemin e përshkruar me përkthimin e ligjeve, si dhe mundësinë e përdorimit të publikimit nga profesionistët që nuk flasin ndonjërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës, është rekomanduar që publikimi i ligjeve të sigurohet edhe në gjuhën angleze. Përkundër faktit që janë shprehur qëndrime të ndryshme, mbizotëron qëndrimi për publikimin në disa gjuhë, që njëkohësisht ka qenë një nga konkludimet e hulumtimit kuantitativ.

> Për mua është shumë me rëndësi versioni zyrtar në gjuhën angleze pasi që ngjan që kemi probleme me përkthimin e ligjeve nga gjuha angleze në atë shqipe, duke ditur që një fjalë e vetme mund të ndryshojë tërë përmbajtjen e ligjit. (stafi i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë)

> Mendoj që do të ishte më mirë sikur publikimi të ishte në të tri gjuhët zyrtare, por që ato të botohen në publikime të veçanta. Secili do të shfrytëzonte publikimin në gjuhën e tij dhe të tjerët do të mund të siguronin gjithnjë publikimin në gjuhën tjetër, nëse janë të interesuar. Për shembull "Gazeta zyrtare" e UNMIK-ut është shumë voluminoze dhe njerëzit hezitojnë ta lexojnë atë. (stafi i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë)

> Ndoshta jam paksa më patriot, por mendoj që edhe nëse publikimi do të ishte vetëm në gjuhën shqipe kjo nuk do të ishte problem, pasi që gjatë seancave kemi përkthyes. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Lëndët që i kam në proces janë në gjuhën shqipe por i kam edhe në gjuhën serbe. Kjo ka të bëj me rastet e ndihmës juridike dhe mendoj që versionet në shqip dhe serbisht mjaftojnë. (Avokati, Prishtinë)

> Shumica e publikimeve janë në të gjitha gjuhët zyrtare prandaj mendoj që edhe ky publikim do të ishte mirë të jetë në të gjitha gjuhët zyrtare, shqipe, angleze dhe serbe. (Avokati, Gjilan)

> Ky lloj publikimi do të ishte mirë të ofrohet në të gjitha gjuhët zyrtare, pa përjashtime. Që një libër të jetë më i afërt me nevojat e shfrytëzuesit, duhet të jetë lehtë i përdorshëm dhe në formatin e duhur. (Avokati, Prishtinë)

Veç kësaj, është me rëndësi të theksohet që ka pasur respondentë të cilët mendojnë se publikimi duhet të përgatitet edhe në gjuhët e pakicave etnike që jetojnë në Kosovë.

> Që një publikim të jetë më modern, duhet të përgatitet në të gjitha gjuhët zyrtare, pasi që nëse kam palë që vijnë nga pakica turke, do të doja që ligji të jetë edhe në gjuhën e tyre. (Avokati, Suharekë)

> Këto publikime, sikur edhe publikimet tjera, duhet të përgatiten në të gjitha gjuhët zyrtare. E theksoj këtë pasi që ka gjyqtarë që u takojnë pakicave dhe ka lëndë në proces të cilat gjykatat i mbajnë edhe në gjuhët tjera. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Ne jetojmë në shoqëri shumë etnike dhe do të ishte mirë që ky publikim të përgatitet edhe në gjuhët tjera. Për shembull, në zyrën time punoj bashkë me një kolegë të pakicës turke, dhe nëse nuk ka një publikim në gjuhën e tij, kjo do të ishte diskriminim për të. (Prokurori, Prizren)

> Mendoj se këto publikime duhet të jenë në gjuhën shqipe, angleze, turke, serbe dhe boshnjake. Pasi që jetojmë në një vend shumë etnik, është mirë që të gjithë qytetarët ti kenë ligjet në gjuhën e tyre. Dhe përveç palëve, kemi edhe kolegë me të cilët punojmë bashkë dhe që u takojnë pakicave prandaj duhet të kemi ligje edhe në gjuhën e tyre. (Gjyqtari, Pejë)

11.4.5. Përmbajtja e publikimit

Për sa u përket nevojave të klientëve potencial, një nga temat më të rëndësishme që kemi diskutuar ka qenë çështja e përmbajtjes së publikimit apo mënyra në të cilën do të duhej organizuar përmbajtja e publikimit. Siç mund të shihet (shih Grafikun 26.), pjesa më e madhe e respondentëve (69.8%) vlerësojnë që nga opsionet e ofruara, më së miri do të ishte që përmbajtja e publikimit të organizohej sipas fushave (p.sh. E drejta penale, e drejta e punës, e drejta e mjedisit, etj.). Një numër më i vogël i respondentëve mendojnë që përmbajtja duhet organizuar sipas renditjes kronologjike (15.1%), dhe me shënimin e freskimeve në tekste (13.1%).

Grafiku 26. Mendoni lidhur me përmbajtjen e publikimeve për të cilat po flasim. Si do të preferonit të jenë të organizuara ato? Do të preferonit organizimin sipas renditjes kronologjike, temave të trajtohen, autoritetit që bën publikimin, me shënimin e freskimeve në tekste, apo mënyra të tjera?



Për sa u përket materialeve legjislative që duhet të jenë pjesë e publikimit, pjesa më e madhe e klientëve të survejuar potencial të publikimit, pajtohen që publikimi në çdo rast duhet të përfshijë ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga PSSP (77.9%). Veç kësaj, diç më pak se gjysma e respondentëve (42.2%) mendojnë që publikimi duhet të përmbajë gjithashtu edhe marrëveshjet e karakterit ndërkombëtar, pastaj legjislacionin sekondar dhe tjetër të nxjerrë nga qeveria dhe ministritë (32.7%), si dhe rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Kosovës (21.1%). Thuajse çdo i pesti respondent (18.6%) mendon që publikimi lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë duhet të përmbajë tërë përmbajtjen e ofruar (shih Grafikun 27.).

Grafiku 27. Sipas mendimit tuaj, cili lloj i materialeve legjislative duhet të jetë pjesë e këtij publikimi?



Pyetja tjetër që u kemi bërë respondentëve ka qenë lidhur me Indeksin që duhet të jetë pjesë përbërëse e publikimit. Sa për faktin që publikimi do të duhej të përmbajë dy lloje të indekseve: a) indeksin e përmbajtjes së publikimit dhe b) indeksin për secilin vëllim, respondentët janë pyetur se në çfarë mase lloji i caktuar i indeksit do të ishte i dobishëm. Sikur që mund të shihet nga Grafiku (shih Grafikun 28.) rreth tri të katërtat e respondentëve mendojnë që të dy llojet e indekseve do të ishin të dobishme apo shumë të dobishme. Nuk ka pasur ndonjë dallim të konsiderueshëm statistikor në mes të kërkesave për lloje të ndryshme të indekseve. 10-15% të respondentëve mendojnë që indekset (e të dyja llojeve) nuk do të kishin asnjë dobi për ta.

Grafiku 28. Indeksi paraqet përmbajtjen, dy lloje të indekseve do të publikohen, a) indeksi i përmbajtjes së publikimit dhe b) indeksi për secilin vëllim. Sa do të jenë të dobishme për ju këto indekse? (N=199)



Në lidhje me freskimet që duhen përfshirë në publikim, mendimet e klientëve potencial ndryshojnë (shih Grafikun 29.). Në të vërtetë, 43.2% e respondentëve kanë thënë që do të dëshironin të marrin vetëm ligjet e ndryshuara, përderisa diç më tepër se gjysma e respondentëve (52.3%) mendojnë që duhet të marrin serinë tërësisht të re të ligjeve komplete.

Grafiku 29. Nëse do të merrni rregullisht publikimin lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, si do të dëshironit t'i merrni freskimet e bëra në tekste?

N=202



Edhe sa i përket përmbajtjes së publikimit, mendimet e respondentëve pjesëmarrës në pjesën kualitative të hulumtimit, ndryshojnë poashtu. Mund të shohim që shumica e respondentëve mendojnë se publikimi duhet të përfshijë të gjitha ligjet e zbatueshme në Kosovë, pavarësisht nga lloji i ligjit dhe origjina e tij. Respondentët kanë theksuar rëndësinë e interpretimit të ligjeve nga ekspertët ligjor, që do të duhej të jetë pjesë përbërëse e publikimit lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

> Do të dëshiroja që ky publikim të përfshijë të gjitha ligjet dhe rregulloret që janë të zbatueshme në Kosovë, pasi që këto materiale janë të nevojshme gjatë procedimit të lëndëve. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Zakonisht mund të gjej tërë atë që më duhet në materialet të cilat i posedoj. Do të ishte shumë mirë po qe se publikimet e reja përfshijnë të gjitha llojet e materialeve në përgjithësi dhe mundësisht të gjitha ligjet të jenë me komente përkatëse, dhe këto komente të jenë të përgatitura nga ekspertët ligjor. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Çfarëdo që të jetë ky publikim apo pa marrë parasysh fushat që trajtohen, është me rëndësi të përfshihen komentet përkatëse dhe këtyre komenteve do të duhej kushtuar shumë kohë. Më besoni që është një zbrazëti e madhe për sistemin gjyqësor të Kosovës që gjatë zbatimit të rregullave ligjore, u kushtohet pak vëmendje apo edhe nuk shfrytëzohet fare praktika gjyqësore. (Avokati, Prishtinë)

> Do të ishte mirë që ky publikim të përfshijë të gjitha ligjet e zbatueshme në Kosovë, përfshirë këtu rregulloret e UNMIK-ut, ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës dhe marrëveshjet ndërkombëtare që janë po aq me rëndësi. (Gjyqtari, Pejë)

> Ky publikim duhet të përfshijë të gjitha dispozitat ligjore në fuqi. Më pas ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës, Rregulloret e UNMIK-ut dhe përgjithësisht ligjet e zbatueshme, marrëveshjet ndërkombëtare etj. (Avokati, Mitrovicë)

> Nga të gjitha alternativat që keni përmendur, mundësisht të përfshihen të gjitha ato (alternativat nga udhëzimet IDI). (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Në fillim dua të theksoj që sistemi i drejtësisë përfshin ligjet civile dhe administrative dhe ato penale. Të gjitha ato ligje do të mund të publikoheshin në një publikim të vetëm. Më parë asnjëherë nuk kanë qenë në një publikim. (Avokati, Gjilan)

Në anën tjetër, ka pasur respondentë që vlerësojnë se në mesin e ligjeve që duhet përfshirë në publikim, nuk duhet të jenë edhe ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës. Në të vërtetë, respondentët mendojnë që këto ligje tanimë janë në dispozicion përmes internetit, por përsëri theksojnë që do të ishte e dobishme të përfshihen interpretimet e tyre.

> Mendoj që ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës nuk ka nevojë të publikohen sepse të gjitha mund të gjenden në internet, por do të ishte mirë të botohen komentet për ligje të caktuara. E them këtë sepse për shumë juristë apo ekonomistë që punojnë me ligjet dhe legjislativin, shumë gjëra mbeten të paqarta. (stafi i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë)

> Besoj që shumë shpejt do të kemi një publikim që do të përmbajë të gjitha materialet që na nevojiten. Do të ishte shumë mirë sikur Gjykata Supreme e Kosovës të publikojë "praktikën gjyqësore" të saj, rreth mënyrës së zbatimit të ligjeve në lëndët penale, civile dhe administrative. (Gjyqtari, Pejë)

Një nga respondentët thotë që do të ishte shumë e vështirë të përfshihen të gjitha ligjet në një publikim dhe sugjeron botimin e disa publikimeve. Këto lloj ligjesh, në këtë rast do të ishin kriteri kryesor sipas të cilit do të ndaheshin materialet në disa publikime.

> Unë personalisht mendoj që është tepër vështirë të përfshihen të gjitha materialet ligjore në një publikim të vetëm. Por do të ishte mirë të kemi publikime të ndara, për shembull njjë publikim për fushën penale, dhe publikimet tjera për fushat civile e administrative. (Avokati, Prishtinë)

Më tej, respondentët kanë folur gjithashtu edhe për përmbajtjen e publikimit dhe lidhur me kriteret që duhen respektuar në ndarjen e publikimit në disa pjesë. Prandaj mund të shohim se respondentët mendojnë që kategorizimi sipas fushave përkatëse do të ishte opsioni më i përshtatshëm për publikimet e këtij lloji.

> Për sa i përket ndarjes së librit në pjesë të veçanta, do të preferoja që kjo ndajre të bëhej sipas fushave që trajtohen. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Librat ndahen sipas temave të tyre, pasi që fusha civile dhe ajo penale nuk mund të jenë bashkë në një publikim. (Prokurori, Prizren)

Për sa i përket indeksit, si pjesë strukturore e publikimit, shumica e respondentëve nuk kanë bërë elaborimin e kësaj çështjeje. Të kujtojmë që analizat e të dhënave kualitative kanë treguar që pjesa më e madhe e respondentëve si klientë potencial të publikimit lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë e shfrytëzojnë indeksin, ndërsa një nga respondentët ka shpjeguar që përdorimi i indeksit e thjeshtëson përdorimin e materialit prandaj edhe do të ishte i dëshirueshëm si pjesë e publikimit.

> Unë zakonisht shfrytëzoj indeksin si orientim për librin, prandaj besoj që indeksi duhet të përfshirë në vëllim dhe siguristh që janë shumë të dobishëm. (I punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

11.4.6. Distribuimi dhe parapagimi

Më tej kemi qenë të interesuar të mësojmë se çfarë mendojnë klientët potencial të publikimit lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, për mënyrat në të cilat duhet bërë distribuimi i publikimit. Opinionet për këtë çështje poashtu dallojnë (shih Grafikun 30.), por mund të thuhet që mbizotëron qëndrimi se publikimi duhet shpërndarë përmes postës, që mbështetet nga 59.3% e respondentëve. Diç më pak se një e treta e respondentëve (29.1%) kanë thënë që do të preferonin shpërndarjen e publikimit përmes dorëzimit personal tek përdoruesit. Gati çdo i dhjeti respondent ka thënë që ai apo ajo do të dëshironte që publikimi të shpërndahet me vetura.

Grafiku 30. Si do të preferonit të bëhej distribuimi i këtij publikimi?



Të ndeshur me përvojën personale negative në raport me distribuimin e publikimeve ekzistuese lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, respondentët pjesëmarrës në pjesën kualitative të hulumtimit kanë theksuar rëndësinë e këtij aspekti në publikimet e këtij lloji. Një numër i madh i respondentëve mendojnë që publikimi duhet të distribuohet tek shfrytëzuesit në mënyrë zyrtare, përmes Postës, dhe kjo zgjidhje është përkrahur nga pjesa më e madhe e respondentëve në hulumtimin kualitativ. Poashtu, një numër më i vogël i respondentëve preferojnë që personalisht ta marrin publikimin. Kjo mund të jetë pasojë e mungesës së besimit në kanalet zyrtare për shpërndarjen e publikimeve.

Pasi që nuk kam mundur ti siguroj publikimet e mëhershme, do të doja ti marr ato personalisht apo të paktën të informohen për botimin e atyre publikimeve. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Zakonisht dërgesa e materialeve të ndryshme që arrijnë në gjykatë bëhet përmes postës, pasi që kjo është një mënyrë më zyrtare për dërgimin e materialeve, prandaj mendoj që ato duhet shpërndarë përmes postëd. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

Është shumë me rëndësi që dërgimi i materialeve të jetë zyrtar. Ekziston lista e avokatëve të Odës sonë dhe materialet mund të dërgohen sipas kësaj liste. Nëse shkoj dhe i marr personalisht nuk do të ketë asnjë efekt pasi që madje edhe dokumentet zyrtare mund të sigurohen në kiosk. (Avokati, Suharekë)

Do të dëshiroja ta marr këtë publikim personalisht pasi që kjo është më e lehtë. (Avokati, Gjilan)

Dërgesa duhet bërë përmes Zyrave Postare pasi kjo mënyrë është më zyrtare. (Gjyqtari, Pejë)

Për sa i përket parapagimit për publikimin respondentët kanë treguar mjaft interesim; thuajse tri të katërtat e respondentëve (72.4%) kanë thënë që do të dëshironin të parapaguajnë për publikimin. Çdo i pesti respondent (20.6%) ka thënë që ai apo ajo do të dëshironte të parapaguhej për publikimin (shih Grafikun 31.).

Grafiku 31. A do të dëshironit të parapaguani publikimin?



Analizat e mëtejme kanë treguar që ekzistojnë dallime ndër-grupore në lidhje me parapagimin për publikimin. Pra, mund të shohim (shih Grafikun 32.) që ka dallime të konsiderueshme statistikore varësisht nga profesioni i respondentëve. Pjesa më e madhe e respondentëve – avokatët (87.7%), në raport me stafin e gjykatave (65.2%) dhe të tjerët

(61.7%), kanë thënë që do të dëshironin të parapaguajnë për publikimin në të cilin kanë treguar interesim më herët.

Grafiku 32. A do të dëshironit të parapagani për publikimin? (Krahasimi në mes avokatëve, stafit të gjykatave dhe të tjerëve)

N=199



11.5. Karakteristikat kryesore dhe shprehitë e klientëve potencial

11.5.1. Kapaciteti i bibliotekave ekzistuese

Pyetja tjetër që u kemi bërë respondentëve ka pasur të bëj me nivelin e disponueshmërisë së materialit dhe literaturës profesionale në zyrën e tyre dhe vlerësimin e kapacitetit të bibliotekave ekzistuese. Siç mund të shihet (shih Grafikun 33.), një numër mjaft i vogël i respondentëve kanë thënë që posedojnë bibliotekë të madhe me më tepër se 500 libra, në zyrën e tyre (4.5%). Më tej, madje 41.1% e respondentëve kanë thënë që nuk kanë fare bibliotekë në zyrën e tyre. Gati një e treta e respondentëve kanë thënë që kanë bibliotekë të vogël me më pak se 500 libra në dispozicion në zyrën e tyre (29.7%), ndërsa një e katërta e respondentëve (24.8%) kanë vetëm një raft librash në dispozicion të tyre. Përgjithësisht mund të konkludojmë që kapacitetet ekzistuese që do të mund t'u shërbenin respondentëve si burim informacioni lidhur me ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë, janë të pamjaftueshme.

Grafiku 33. Ju lutemi zgjidhni përshkrimin më të mirë të bibliotekës në zyrën tuaj (biblioteka e hapësirës ku ju punoni/studioni):



11.5.2. Qasja në internet

Për sa i përket shprehisë për shfrytëzimin e internetit, thuajse dy të tretat e respondentëve (64.4%) kanë thënë që e shfrytëzojnë internetin, përderisa 35.6% kanë thënë që nuk e shfrytëzojnë internetin (shih Grafikun 34.). Respondentët që shfrytëzojnë internetin, kryesisht këtë e bëjnë nga shtëpia (40.8%), nga vendi i punës (33.1%), në internet kafe (22.1%), dhe nga vende të tjera (shih Grafikun 34.).

Grafiku 34. A e shfrytëzoni internetin?



Nga respondentët që e shfrytëzojnë internetin, pjesa më e madhe (95.4%) pajtohen që do të dëshironin të kenë qasje përmes internetit në bazën e shënimeve që i përmban të gjitha ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë (shih Grafikun 35.).

Grafiku 35. A do të dëshironit të keni qasje përmes internetit në bazën e shënimeve që do t'i përmbante të gjitha ligjet dhe materialin tjetër legjislativ të zbatueshëm në Kosovë?



Për sa i përket qasjes në internet në vendin e tyre të punës, 24.3% e respondentëve kanë thënë që nuk kanë në plan të kenë qasje në internet, në gjashtë muajt e ardhshëm. Një numër shumë i vogël i tyre (3.5%) tanimë kanë qasje në internet në vendin e tyre të punës

dhe 60.9% e respondentëve planifikojnë të lidhen me internet në gjashtë muajt e ardhshëm (shih Grafikun 36.).

Grafiku 36. A keni në plan të lidheni me internet në vendin tuaj të punës, në gjashtë muajt e ardhshëm?



Në fund, me respondentët pjesëmarrës në hulumtimin kualitativ kemi biseduar për shprehitë e tyre në përdorimin e kompjuterit. Mund të konkludojmë që shumica e respondentëve në këtë fazë të hulumtimit, tanimë përdorin kompjuterin apo planifikojnë përdorimin e tij në një të ardhme të afërt. Në çdo rast, respondentët pajtohen që njohuritë për punë me kompjuter këto ditë janë të domosdoshme.

> Natyrisht që shfrytëzoj kompjuterin pasi që tërë punën time e kryej me kompjuter. Përveç për punë, kompjuterin e shfrytëzoj edhe për qëllime të tjera. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> E shfrytëzoj kompjuterin por jo aq shpesh pasi që me futjen e shënimeve kryesisht merret daktilografia. Shkaku tjetër pse nuk e shfrytëzoj kompjuterin është që nuk kam qasje në internet në zyrë. Ka kohë që na është thënë se do të kemi lidhje me internet në zyrat tona, por deri më sot asgjë nuk ka ngjarë në këtë drejtim. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Nuk e shfrytëzoj kompjuterin. Që kur kam filluar punën, jam mësuar të punoj me një "makinë shkrimi" të vjetër. Tani e kam ndërruar zyrën dhe kam porositur kompjuterin, prandaj do ta kem atë së shpejti. (Avokati, Gjilan)

> Në kohërat tona, nuk ka asnjë avokat që nuk posedon kompjuter, prandaj as unë nuk bëj përjashtim. E shfrytëzoj kompjuterin tani një kohë të gjatë dhe është bërë pjesë e punës sime të përditshme. (Avokati, Prishtinë)

> E shfrytëzoj mjaft kompjuterin. Që kur kam hapur zyrën time, kam blerë edhe kompjuterin. Sikur që mund të shihni, të gjitha punët i kryej me kompjuter. Mendoj që në vitin 2005, nëse nuk dini të përdorni kompjuterin kjo do të jetë një mangësi e madhe, e veçmas për avokatët që gjatë tërë kohës duhet të shkruajnë dokumente të ndryshme, etj. (Avokati, Mitrovicë)

> Këtu në zyrë punoj me bashkëpunëtorin juridik. Ata zakonisht merren me procesverbalet prandaj unë nuk shkruaj edhe aq shumë. (Prokurori, Prizren)

Rëndësia e njohurive të internetit shihet gjithashtu si mjaft domethënëse. Shumë nga respondentët kanë thënë që tanimë e shfrytëzojnë internetin për nevojat e tyre profesionale apo që planifikojnë ta bëjnë këtë në të ardhmen. Megjithatë, disa nga respondentët e nënvlerësojnë rëndësinë e internetit si media. Duket që situata është e pafavorshme në institucionet shtetërore, që kanë mbetur pas në trendet e përgjithshme të kompjuterizimit, që pasqyrohet në mungesën e kompjuterëve dhe lidhjet me internet në zyrat e tyre.

> Janë shumë të rëndësishme shkathtësitë e përdorimit të internetit. Për ata që dijnë si të përdorin internetin, nuk është aq vështirë të informohen pasi që në ueb faqen e Kuvendit të Kosovës mund të gjeni të gjitha ligjet, prandaj edhe sigurimi i informacioneve lidhur me ligjet e zbatueshme nuk është aq i vështirë. (Avokati, Prishtina)

> Kam lidhje me internet në shtëpi dhe e shfrytëzoj mjaft. E shfrytëzoj internetin për të qenë i informuar mbi ligjet e reja dhe për të komunikuar me njerëzit. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

> Personalisht e shfrytëzoj internetin dhe të gjitha programet. Këtu në zyrë kam lidhje me internet por profesorët dhe zyrat tjera nuk kanë po të njëjtën gjë. (stafi i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë)

> Këtu në zyrë kam lidhje me internet dhe e kam pasur që kur kam hapur zyrë. E shfrytëzoj për të qenë i informuar për ligjet e ndryshme por edhe për nevoja personale. (Avokati, Prishtinë)

> Thuajse çdo gjë që bëj, e bëj me kompjuter. Në zyrë kam lidhje me internet përmes linjës telefonike. Megjithatë internetin e shfrytëzoj vetëm për email pasi që të ardhurat e mia nuk më mundësojnë lidhje 20 orëshe me internet. (Avokati, Prishtinë)

> Tani nuk e shfrytëzoj internetin, pasi që edhepse interneti është shumë i dobishëm, në fund është vetëm humbje kohe. (Avokati, Mitrovicë)

> Këtu prokurorët nuk kanë qasje në internet. (Prokurori, Prizren)

> Këtu në Gjykatën e Qarkut në Pejë nuk kemi internet pasi që nuk e kanë rregulluar ende por mendojmë të lidhemi në të ardhmen. (Gjyqtari, Pejë)

> Mendojmë që në një të ardhme të afërt, secili profesor këtu në Fakultetin e Drejtësisë do të ketë lidhje interneti në kabinetin e tij, por kjo nuk është arritur ende. (stafi i Fakultetit të Drejtësisë, Prishtinë)

Këtu në Gjykatën e Qarkut punoj për shumë vite dhe ende nuk kemi lidhje interneti. Kemi aq shumë nevojë për internet në zyrë këtu, ka pasur disa përgatitje dhe gjithçka është gati për lidhje me internet, por ende nuk e kemi atë. Na është premtuar më herët që do të kemi internet por deri më sot nuk është bërë asgjë. Nuk jam i sigurtë se kur do të kemi lidhje me internet në të ardhmen. (i punësuari i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë)

11.5.3. Tabela e indeksit

Në fund, i kemi pyetur respondentët nëse e shfrytëzojnë ndonjëherë tabelën e indeksit kur bëjnë leximin e librave dhe publikimeve ligjore. Shumica dërrmuese e respondentëve kanë thënë që gjithmonë e shfrytëzojnë tabelën e indeksit (60.8%), apo vetëm ndonjëherë (32.7%). Një numër shumë i vogël i respondentëve e shfrytëzojnë tabelën e indeksit rrallë apo asnjëherë (shih Grafikun 37.).

Grafiku 37. A e shfrytëzoni zakonisht tabelën e indeksit në librat apo publikimet tjera lidhur me çështjet ligjore?



12. Konkluzionet

§ Klientët potencial të versionit të shtypur të publikimit lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, duhet të shfrytëzojnë edhe burime të tjera, jozyrtare të informimit lidhur me ligjet dhe çështjet ligjore.

§ Lidhur me publikimet konkrete të cilat janë përmendur se përdoren nga respondentët tanë, duket që "Gazeta zyrtare" e UNMIK-ut është në përdorim standard si burim informacioni për ligjet që zbatohen në Kosovë.

§ Përgjithësisht, mund të konkludohet që nuk ka një sistem standard të shpërndarjes së publikimeve lidhur me ligjet e zbatueshme dhe përmes të cilit të gjithë përdoruesit e interesuar do të mund të siguronin materialet e nevojshme lidhur me çështjet ligjore.

§ Respondentët që pranojnë rregullisht disa nga publikimet ekzistuese lidhur me ligjet e zbatueshme në Kosovë, janë kryesisht të pakënaqur me atë që ofrohet në këto publikime. Ankesat e respondentëve kanë të bëjnë kryesisht me përmbajtjen dhe formatin e publikimit.

